



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

**A.nr.372/2021**

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Burim Ademi kryesues, Zyhdi Haziri dhe Ferki Xhaferi anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares se lartë ligjore Antigona Murati, duke vendosur përkitazi me ankesën e Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), paraqitur kundër subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), për shkak të vendosjes së shiritave të kuqe në vende publike, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen më datë 14.02.2021, në seancën e panelit të mbajtur më datë 12.02.2021, mori këtë:

### V E N D I M

**Refuzohet** e pabazuar ankesa Anr.372/2021 e datës 11.02.2021, e paraqitur nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me të cilën ka kërkuar që subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), t'i shqiptohet gjobë për shkeljen e Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, për vendosjen e shiritave të kuqe në vende publike.

### A r s y e t i m

Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), ka parashtruar ankesën A.nr.372/2021, me datë 11.02.2021, në PZAP, më të cilën pretendon se Lëvizja Vetëvendosje ka bërë shkelje të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, nenit 33, pika b) dhe Kodit të Mirësjelljes përgjatë fushatës zgjedhore, të cilët me hapjen e fushatës zgjedhore kanë vendosur shirita me ngjyrë të kuqe në vende publike, në sheshe e të ngjashme.

Paraqitësi i ankesës në mbështetje të pretendimeve në ankesë, si dëshmi ka bashkangjitur disa fotografi të printuara.

PZAP-i, më datë 12.02.2021, konform nenit 7, par.1, të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, njoftoi subjektin politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), për ankesën e paraqitur, duke i dhënë kohë për përgjigje deri më datë 12.02.2021 në ora 18:00.

Në përgjigjen në ankesë të datës 12.02.2021, subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), thekson se Lëvizja Vetëvendosje, konkretisht shtabet përkatëse nuk kanë dhënë asnjë direktivë që ato fjonga të vendosen në rrugët përkatëse. Pra, ato shirita apo fjonga të kuq nuk kanë asgjë të bëjnë me Lëvizjen Vetëvendosje.

Më tutje në përgjigjen në ankesë, Lëvizja Vetëvendosje deklaroi se slogani i saj për këto zgjedhje është “Krejt dhe Drejt” ka llogon e saj zyrtare të cilat në asnjë rrethanë nuk identifikohen me shiritat e kuq. Neni 33 pika b) në të cilin është bazuar ankuesi pretendon se nuk lidhet me asnjë veprim ndalues të LVV-së, pasi që neni 33 pika b) përcakton se

“veprim i ndaluar i subjekteve politike dhe mbështetësit e tyre janë: vendosja e njoftimeve, pllakatave dhe posterëve ose përndryshe, vendosja e emrave të tyre ose sloganeve në lidhje me fushatën zgjedhore, Lëvizja Vetëvendosje pretendon se nga kjo dispozitë që ju ka referu parashtruesi vërtetohet qartë se Lëvizja Vetëvendosje dhe shtabet e saj nuk kanë vendosur asnjë material zgjedhor në rrugët përkatëse publike lidhur me “njoftim, pllakata apo posterë ose vendosjen e emrave të tyre ose sloganeve. Propozon PZAP-in se ankesa e parashtruar nga subjekti politik LDK të refuzohet si e pabazuar.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën vlerësoi se:

### **Ankesa është e pabazuar,**

Nga shkresat e lëndës vërtetohet se Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), ka parashtruar ankesë në PZAP A.nr.372/2021 më datë 11.02.2021, me të cilën pretendon se subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), ka vendosur shirita të kuqe në vende publike.

Pas pranimit të ankesës në PZAP, e njëjta i është dërguar subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) për përgjigje në ankesë.

Subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) me datë 12.02.2021, ka paraqitur përgjigje në ankesë, duke i kundërshtuar në tersi pretendimet e ankuesit të parashtruara në ankesë dhe duke kërkuar që ankesa të refuzohet e pa bazuar.

Duke u nisur nga arsyet e theksuara me lartë, Paneli konstatoi se nga ana e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) nuk është bërë shkelje e nenit 33, pika b) të LZP-së, ku thuhet se *“vendosja e njoftimeve, pllakateve dhe posterëve, ose përndryshe, vendosja e emrave të tyre ose e sloganeve në lidhje me fushatën zgjedhore brenda ose jashtë ndërtesave publike ose godinave, në apo mbi rrugët publike, në shenjat publike të trafikut, brenda ose jashtë hapësirave ose ndërtesave të zëna ose, ndryshe, që shfrytëzohen nga organizatat ndërkombëtare, ose brenda ose në hapësirat private pa lejen e pronarëve ose shfrytëzuesve”*.

Paneli erdhi në përfundim se janë të paqëndrueshme pretendimet e paraqitësit të ankesës se këto veprime përbëjnë shkelje të Kodit të Mirësjelljes nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), për shkak se nga fotot e ofruara si dëshmi në ankesë nuk është vërtetuar se të njëjtat janë vendosur nga Lëvizja Vetëvendosje. Për më tepër, vendosja e këtyre shiritave në hapësira publike nuk është paraparë si shkelje në Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme, neni 33, pika b), me konkretisht nga shiritat ngjyrë te kuqe qe vërehen nga ana e provave/fotove te paraqitura nga ankuesi, rezulton se si te tilla ato nuk janë, njoftime, pllakate apo posterë, nuk kanë emra apo slogane qe ne çfarëdo rrethane do te munde te identifikonin lëvizjen vetëvendosje si cënuesë të rregullit nga neni 33 pika b), e ligjit. Ne rrethana te tilla PZAP, vlerëson se për tu konsideruar shkelje veprimi i tille duhet te plotësohen dy kushte në mënyrë kumulative, dhe atë: 1. Qe subjekti politik, kandidatet apo mbështetësit te kenë ndërmarr veprimin qe është ne kundërshtim me nenin 33 te LZP-ës, si dhe, 2. Qe materiali i tillë te jete i identifikueshëm, me njoftim, pllakat, poster, emër apo slogan ne lidhje me fushatën zgjedhore. Ne rastin konkret nuk është e mjaftueshme qe te evidentohet fakti se veprimet e tilla a i ka ndërmarr një mbështetës i një subjekti te caktuar

politik qe i është nënshtruar garës për zgjedhjet e Kuvendit të Republikës së Kosovës kur nuk plotësohet kushti tjetër ligjor lidhur me identifikimin e atij subjekti politik. Andaj si të tillë Paneli e refuzoj ankesën si të pabazuar.

Nga arsyet e theksuar më lartë, e duke u bazuar në nenin 118 par.1 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**  
Anr.372/2021 më datën 12.02.2021

**Kryesuesi i Panelit**

**Burim Ademi**



*Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 1 të LZP-së.*